



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
H./Z./S. 02	Nr./Br./No. 6552
Nr. ifaq. Br. Str. No. Pg. 2	Data: Datum: Date: 13/03/2016
KAMENICË - KAMENICA	

NJOFTIM / KËRKESË

Për aplikim për verifikimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve/individëve në njësitë e banimit social me qira joprofitabile

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenin 12 dhe 13, si dhe në Udhëzimet Administrative Nr. 21/2010, Nr. 22/2010 dhe Nr. 23/2010, Komuna e Kamenicës në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues për verifikimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve/individëve në njësitë e Banimit Social, njofton të gjithë shfrytëzuesit aktualë të njësive të banimit social se janë të obliguar të paraqesin aplikacionin për verifikimin e gjendjes së tyre ekonomike e sociale, në mënyrë që të përcaktohet e drejta e vazhdimit të shfrytëzimit të banesës me qira joprofitabile.

Afati i aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve të familjes/ individit të vendosura në njësi banimi në kuadër të ndërtesës së banimit social është 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit të këtij njoftimi. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Vendi i dorëzimit

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në objektin e Komunës Kamenicës kati i I – rë..

Forma e aplikimit

Aplikacioni plotësohet në Formën zyrtare të kërkesës (Shtojca Nr. 1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2010), e cila merret në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Objektin e Komunës, pranë Zyrës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Qendrës për Punë Sociale ose shkarkohet nga faqja zyrtare e Komunës së Kamenicës.

Dokumentet që duhet të bashkëngjiten:

1. Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës ;
2. Certifikatat e lindjes për anëtarët e familjes;
3. Certifikata familjare;
4. Vërtetim mbi vendbanimin e përhershëm;
5. Të dhënat për anëtarët e punësuar (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
6. Vërtetim nga MTI se kërkuesi dhe familja nuk kryejnë aktivitet tregtar;
7. Vërtetim nga Enti për Punësim për të gjithë anëtarët e papunë;
8. Vërtetim mbi shkollim e rregullt;
9. Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit apo anëtarëve të familjes, lëshuar nga entet shëndetësore të autorizuar;
10. Vërtetim për statusin e familjes së dëshmorit (nëse aplikohet);
11. Vërtetim për përkujdesje ndaj fëmijëve jetim (nëse aplikohet);
12. Dokumente shtesë sipas rastit.

Vërejtje;

Mosdorëzimi i aplikacionit dhe dokumenteve të kërkuara brenda afatit të caktuar mund të rezultojë me shkëputjen e kontratës së qirasë, në përputhje me nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-164.

Komisioni Vlerësues për Banimin Social
Komuna e Kamenicës